



Republika e Kosovës  
Republika Kosovo-Republic of Kosovo  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

Legjislatura III  
Sesioni vjeshtor

Komisioni për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion

Mbledhja nr. 27/2009  
Më 24. 11. 2009, në orën 11:00  
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10

**Procesverbal**

**Në mbledhje morën pjesë:** Myzejene Selmani, kryetare, Ethem Çeku, Kaqusha Jashari, Mufera Sinik, Nerxhivane Dauti, Qamile Morina dhe Zef Morina.

**Munguan:** Slobodan Petroviq, Sala Berisha – Shala dhe Fatmir Rexhepi.

**Pjesëmarrës të tjerë:** Haxhi Gashi – USAID, Besim Zeqiri – ICO, Ramadan Klisurica – KDI dhe Ibrahim Krasniqi, konsulent i Komisionit.

**Nga Zyra Mbështetëse:** Hasan Tahiri, Advije Morina, Armend Ademaj dhe Besim Haliti.

Mbledhjen e drejtoi: Myzejene Selmani, kryetare e Komisionit.

**Rendi i ditës**

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 23.10. 2009;
3. Miratimi i rekomandimit të propozimvendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës nr.03/71 të 03. 07.2009, për emërim të anëtarëve të Bordit të Autoritetit Rregullator të hekurudhave në Republikën e Kosovës,
4. Miratimi i Raportit me rekomandime të Projektligjit për masat antidamping,
5. Të ndryshme.

## I. Miratimi i rendit të ditës

*Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.*

## II. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 23.10. 2009

*Procesverbali i mbledhjes së datës 23.10. 2009 u miratua pa vërejtje.*

III. Miratimi i rekomandimit lidhur me propozimvendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës nr.03/71 të 03. 07. 2009, për emërim të anëtarëve të Bordit të Autoritetit Rregullator të hekurudhave në Republikën e Kosovës

**Myzejene Selmani** –kryetare e Komisionit, ua përkujtoi anëtarëve të Komisionit se në mbledhjen e fundit Komisioni e ka shqyrtuar propozimvendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës nr.03/71 të 03. 07. 2009, për emërim të anëtarëve të Bordit të Autoritetit Rregullator të hekurudhave në Republikën e Kosovës. Komisioni nuk e ka mbështetur propozimvendimin me arsyetim se kandidatët e propozuar nuk i plotësonin kushtet e nenit 7, të Ligjit për hekurudhat e Kosovës. Komisioni ka autorizuar ekipin ta hartojë rekomandimin për Kuvend, që tani Komisioni e ka për detyrë t'i verifikojë saktësinë dhe bazueshmërinë e rekomandimit.

Anëtarët e Komisionit Ethem Çeku, Zef Morina dhe Kaqusha Jasharit, shprehën dilema se rekomandimi duhet t'i dërgohet drejtëpërdrejt Kuvendit ose Kryesisë së Kuvendit. Pas sqarimeve që u bënë nga mbështetësit e Komisionit u përfundua që rekomandimi t'i dërgohet Kuvendit për miratim nëpërmjet Kryesisë së Kuvendit.

Komisioni me votim unanim miratoi këtë :

### **Rekomandim**

- I. Kuvendi i Republikës së Kosovës nuk e mbështet propozimvendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës nr.03/71 të 03. 07. 2009, për emërim të anëtarëve të Bordit të Autoritetit Rregullator të hekurudhave në Republikën e Kosovës.
- II. Kuvendi kërkon nga Qeveria e Republikës së Kosovës të propozojë kandidatë të tjerë, ngase të kandiduarit nuk i plotësojnë kushtet e parapara me Ligjin për hekurudhat në Republikën e Kosovës.

## IV. Miratimi i Raportit me rekomandime për Projektligjin për masat antidamping

**Myzejene Selmani**, ua përkujtoi anëtarëve të Komisionit për ETIETT se amendamenti i Projektligjit për masat antidamping është bërë më 21. 07. 2009, sipas rregullave procedurale komisionet kryesore e kanë shqyrtuar sipas kompetencës amendamentimin e Projektligjit përfundimisht më 15. 10. 2009. Komisionet kryesore e kanë mbështetur amendamentimin e Projektligjit nga komisioni funksional. Ajo propozoi që nëse nuk ka

vërejtje në raportin e hartuar, të miratohet dhe të procedohet për lexim të dytë sipas rregullave procedurale.

Pas debatit, Komisioni nxori këtë:

### **Përfundim**

Miratohet Raporti me rekomandime për Projektligjin për masat antidamping.  
Raporti procedohet për lexim të dytë.

V. Të ndryshme

Pas shqyrtimit të çështjeve vijuese, Komisioni nxori këtë:

### **Përfundim**

- I.** Grupin e Punës për Projektligjin për shërbimet postare ta udhëheqë Zef Morina;
- II.** Grupin e Punës për Projektligjin për luftën kundër krimit kibernetik, ta udhëheqë Nerxhivane Dauti, poashtu anëtare e Grupit të Punës për Projektligjin për turizmin dhe shërbimet turistike;
- III.** Grupi i Punës për Projektligjin për turizmin dhe shërbimet turistike, plotësohet me Qamile Morinën.
- IV.** Mbledhja përfundoi në orën 12: Mbledhja e radhës mbahet më 01 dhjetor 2009, në të cilën do të shqyrtohet Raporti i punës gusht 2008 – gusht 2009 i Agjencisë Kosovare të Privatizimit. Në këtë takim ftohen përfaqësuesit e AKP- së.

00

Kryetare e Komisionit

---

Myzejene Selmani